

# Java Kulturore Holandeze

09-11 Tetor





# 9 Tetor



**ORA: 11:00 – Ceremonia Hapëse**

**AJAX – 17 NËNTORI / TIRONA – RITAKIM DHE EKSPOZITË FOTOGRAFIKE**

Më 17 nëntor 1970 u rivendosën marrëdhëniet diplomatike mes Holandës dhe Shqipërisë. Në kuadër të 55-vjetorit organizohet aktiviteti që kujton ndeshjen historike Ajax – 17 Nëntori, e cila përfundoi 2-2 dhe u bë e njohur edhe për një episod diplomatik unik mbi hyrjen e lojtarëve holandezë në Shqipëri. Legjendat Arie Haan dhe Ruud Krol rikthehen për t'u takuar me ish-lojtarët shqiptarë, në një ribashkim që shoqërohet me panel diskutimi dhe ekspozitë fotografike me imazhe të papublikuara.

**EKSPOZITA DO TË JETË E HAPUR NGA DATA 9 - 11 TETOR**

**STADIUMI AIR ALBANIA – TIRANË**



# 9 – 11 Tetor

9 Tetor, Ora: 17:30 – Ceremonia Hapëse

10 Tetor, Ora: 17:00 – Guidë e drejtuar nga Arnout Van Krimpen

## **EKSPOZITA "AMSTERDAM RAINBOW DRESS "**

Ekspozita prezanton një fustan unik krijuar nga flamujt e vendeve ku orientimi queer ende është krim. Me kalimin e kohës, flamujt e vendeve që dekriminalizojnë queer-in zëvendësohen nga rainbow, duke e bërë fustanin një vepër arti që simbolizon përparimin dhe sfidat e vazhdueshme. Ekspozita përfshin 30 fotografi dhe do të shoqërohet me vizitë të udhëhequr nga Arnout Van Krimpen.

**EKSPOZITA DO TË QËNDROJË E HAPUR NË DATAT 10 - 11 TETOR,  
ORA 10:00 – 13:00 DHE 17:00 – 20:00**

**VILA 31 – TIRANË**



Java **Kulturore**  
Holandeze

# 11 Tetor



**ORA: 17:00**

## **DIALOGË ME ARTISTË – LIDHJET MES SË KALUARËS DHE SË ARDHMES**

Ky aktivitet ofron dy perspektiva të veçanta mbi lidhjen mes kujtesës dhe inovacionit. Kuratorja Kim Knoppers diskuton konceptin e kurimit transhistorik dhe rëndësinë e qendisjes dhe tekstileve si mjete për të ruajtur kujtime, për të ushqyer rezistencën dhe për të nxitur shërimin. Ndërkohë, dizajnerja industriale holandezo-shqiptare Felice Emanuels tregon se si motivet tradicionale shqiptare të qendisjes transformohen në tekstile bashkëkohore përmes teknikave moderne të dizajnit industrial holandez.

**VILA 31 – TIRANË**